

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për projektligjin “Për Vullnetarizmin”

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët fton të rinjtë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për Vullnetarizmin”.

MSHRF mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- kuadri ligjor për vullnetarizmin;
- rritjen e pjesëmarrjes aktive dhe fuqizimin e grupeve vulnerabël;
- krijimin e regjistrit elektronik për vullnetarizmin.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Procesi i konsultimeve për rishikimin e Ligjit “Për Vullnetarizmin”, nëpërmjet publikimit në RENJK do të zgjasë nga data 18.11.2024 deri më datë 16.12.2024.

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

1. Gjatë konsultimeve fizike dhe online që do të zhvillohen;
2. Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresat oltion.pengu@kryeministria.al; rinia@kryeministria.al;
3. Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/800>

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Z. Oltion Pengu, përfaqësues për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

e-mail-i: oltion.pengu@kryeministria.al; rinia@kryeministria.al

numri i telefonit: 0684037864

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Konsultime fizike dhe online, me aktorët e synuar dhe grupet e interesit për ndërmarrjen e vlerësimit ex post të ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe akteve nënligjore dhe përgatitjes së propozimeve ligjore bazuar në vlerësimin e nevojave, synimeve, prioriteteve dhe propozimeve të aktorëve shoqëror ku përfshihen:

- Takim online, mbajtur më 29.03.2022, mes ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zëvendësministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe drejtorit të AKPA-së me përfaqësuesit e 11 organizatave të shoqërisë civile për rishikimin e ligjit për vullnetarizmin.

- Takim mbajtur më 22.04.2022 pranë AKPA-s, mes përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për punën, MSHRF-së, AKPA dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për rishikimin e ligjit për vullnetarizmit.

- Takimi i online mbajtur më 04.07.2024, mes GNP-së dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile me fokus konsultimin e propozimeve të grupit të punës për çështjet që do të adresohen në kuadër të rishikimit të ligjit për vullnetarizmin.

- Aktiviteti Ligji për vullnetarizmin në Shqipëri – si prioritet për zhvillimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, mbajtur më datë 09.07.2024, në Tiranë, me rreth 50 përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave aktive dhe kontribuuese për vullnetarizmin në Shqipëri, përfaqësuesve të MSHRF, MEKI, AKPA, AKR si dhe të rinj e vullnetarë, me fokus diskutimin, dhënë rekomandime dhe sugjerime në kuadër të nevojave dhe çështjeve që duhen të adresohen në projekt-ligjin e ri, si dhe ndarjen e eksperiencave dhe praktikave më të mira europiane sa i përket kuadrit ligjor dhe zbatimit të politikave të suksesshme për vullnetarizmin.

- Takimi i GNP-së zhvilluar me datë 10.07.2024, pranë zyrave të AKPA-s, i mbajtur bashkërisht me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe ekspert ndërkombëtar për vullnetarizmit, për diskutimin elementëve specifik të ligjit dhe qasjet për adresimin e tyre, bazuar në përvojën ndërkombëtare.

- Turi i konsultimeve me të rinjtë “Rinia ndryshon ligjet”, për rishikimin e ligjit “për vullnetarizmin” u zhvillua gjatë muajit korrik 2024, përmes takimeve të organizuara dhe të drejtuara nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e grupit të punës, duke përfshirë takime të veçanta në 11 bashki të vendit dhe në një Bootcamp të dedikuar tre ditor.

- Konsultim i datës 25.11.2024 me ekspertët e projektit UNOPS për harmonizimin e propozimeve ligjore me rekomandimet e Këshillit Evropian.

2. Konsultime përmes emailit, ku aktorët e shoqërisë civile patën mundësinë të dërgonin propozimet e tyre tek anëtarët e grupit të punës.

3. Konsultime përmes REJNK, në datat 18.11.2024-16.12.24.

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/800>

Sfondi i propozimit legjislativ

Ligji ekzistues Nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, ka dëshmuar mangësi të theksuara në zbatimin e tij praktik, duke frenuar potencialin e plotë të vullnetarizmit në Shqipëri. Problemi

buron nga disa aspekte strukturore të ligjit që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ofruesit, vullnetarët dhe përfituesit e aktiviteteve vullnetare.

Së pari, mungesa e përkufizimeve të qarta dhe të plota mbi konceptin ligjor të vullnetarizmit dhe elementët përbërës të tij, e bën të vështirë dallimin e marrëdhënies vullnetare nga ato të punësimit apo shërbimeve të kontraktuara. Ky boshllëk ligjor dhe paqartësitë e krijuara, kanë frenuar zbatimin e ligjit, kanë penguar rritjen e veprimtarisë vullnetare dhe kanë lënë pa mbrojtje të mjaftueshme aktorët e përfshirë.

Së dyti, ligji aktual përmban përcaktime të pa qarta dhe kontradiktore mbi llojin e sigurimit të shëndetit që ofruesi i vullnetarizmit detyrohet të mbulojë vullnetarin, përgjatë angazhimit të tij. Kjo ka krijuar pasiguri juridike për organizatat që ofrojnë vullnetarizëm, duke frenuar formalizimin dhe deklarimin e vullnetarëve më së shumti, ose duke detyruar deklarimin e vullnetarëve si punëmarrës dhe marrë përsipër detyrime financiare që nuk i takojnë në disa raste, si dhe duke lënë pa mbrojtje individët që angazhohen si vullnetarë nga ana tjetër.

Së treti, ligji aktual përmban përcaktime të pa qarta mbi qëllimin, mbajtjen dhe përdorimin e regjistrit të vullnetareve, duke krijuar konfuzion dhe dekurajuar ofruesit e vullnetarizmit që të regjistrojnë dhe të raportojnë të dhënat e vullnetarizmit. Sikundër, kuadri ligjor për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare në nivel kombëtar vlerësohet i pa përshtatshëm për të matur ndikimin real të vullnetarizmit në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Së katërti, detyrimet e ligjit aktual për kontraktimin e marrëdhënies vullnetare janë të pa përshtatshme për rregullimin e formave të vecanta të vullnetarizmit, si vullnetarizmi rastësor apo vullnetarizmi masiv. Kjo i bën rregullimet ligjore jo efektive dhe frenon veprimtarinë vullnetare në vend.

Në të njëjtën kohë, vullnetarizmi bart vlera të vecanta, pasi shërben si instrument efektiv për promovimin e solidaritetit shoqëror, zhvillimin e vlerave njerëzore dhe përfshirjen aktive të qytetarëve. Në mënyrë që këto vlera të mbështeten dhe promovohen në shoqëri, vlerësohet e nevojshme që kuadri ligji për vullnetarizmin, i cili aktualisht ka qëllim vetëm rregullimin, të zgjerohet duke përfshirë dhe mekanizma ligjorë, institucionalë dhe financiar për nxitjen, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e vullnetarizmit në vend.

Për rrjedhojë, nevoja e adresimit të këtyre mangësive në mënyrë efektive dhe referuar shkallës së ndryshimeve thelbësore të kërkuara, ka krijuar domosdoshmërinë për një rishikim të plotë të ligjit, për të krijuar një kuadër ligjor të qëndrueshëm dhe të favorshëm për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë.

Propozimet

Objektivat e synuara nga projektligji përfshijnë krijimin e një kuadri ligjor efektiv për vullnetarizmin, lehtësimin dhe rritjen e efektivitetit në regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi vullnetarizmin, mbrojtjen dhe fuqizimin e vullnetareve, promovimin dhe njohjen e vlerave të vullnetarizmit, si dhe nxitjen e veprimtarisë vullnetare në tërësi. Më poshtë janë identifikuar në detaje objektivat e këtij projektligji.

1. Krijimi i një kuadri ligjor efektiv për vullnetarizmin:

- Prezantimi i konceptit ligjor të vullnetarizmit, elementët përbërës të tij, formave të ndryshme të veprimtarisë vullnetare dhe përkufizimin i subjekteve të vullnetarizmit.
- Përcaktimi i parimeve bazë dhe të pa cënueshme që udhëheqin të gjitha format e vullnetarizmit, duke përfshirë vullnetin e lirë, mosdiskriminimin, mungesën e përfitimit material dhe ndalimin e shfrytëzimit.
- Prezantimi i rregullimeve ligjore efektive dhe që harmonizohen me format e ndryshme të veprimtarisë vullnetare, sa i takon organizimit dhe monitorimit të vullnetarizmit, dhe çështjeve të lidhura me angazhimin, sigurimin dhe regjistrimin e vullnetarëve.
- Parashikimi i kontratës së vullnetarizmit dhe elementëve përbërës së saj, si dhe rregullat për kryerjen e vullnetarizmit pa lidhjen e kontratës.
- Prezantimi i kodit të etikës së vullnetarit, duke përcaktuar rregullat e pranueshme të sjelljes për vullnetarin, ofruesin e vullnetarizmit dhe kundrejt përfituesit të vullnetarizmit.
- Parashikimit të sanksioneve administrative të posaçme për shkeljet e detyrimeve të ligjit.

2. Lehtësimi dhe rritja e efektivitetit në regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi vullnetarizmin:

- Krijimi i një regjistri elektronik për mbledhjen e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe lëshimin dhe plotësimin e librezës së vullnetarit në format elektronik.
- Përcaktimi i formave të grumbullimit dhe raportimit të aktiviteteve vullnetare për të siguruar transparencë dhe informacion të përditësuar.
- Parashikimi i prodhimit të statistikave zyrtare për vullnetarizmin, për matjen e kontributit vullnetar në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë dhe për rritjen e efektivitetit të politikave publike në këtë fushë.

3. Mbrojtja dhe fuqizimi i vullnetarëve:

- Përcaktimi i llojit të sigurimit të detyrueshëm me të cilin ofruesi i vullnetarizmit do të mbulojë vullnetarin si dhe mënyrën e deklarimit të tij.
- Rritja e përfshirjes së të miturve, të rinjve dhe personave nga grupet vulnerabël në vullnetarizëm përmes masave specifike mbështetëse dhe mbrojtëse për ta.
- Përcaktimi i shpenzimeve të rimbursueshme për vullnetarin gjatë vullnetarizmit.
- Parashikimi i të drejtave dhe detyrimeve të vullnetarit, dhe rregullimeve të posaçme që i mbrojnë ata nga shfrytëzimi, diskriminimi, cenimi i personalitetit, shtrëngimi dhe rrezikimi i sigurisë dhe shëndetit personal.

4. Promovimi dhe njohja e vlerave të vullnetarizmit:

- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve, të rinjve dhe grupeve të tjera shoqërore mbi konceptet dhe rëndësinë e vullnetarizmit për shoqërinë dhe individin, si dhe të aftësimit së të rinjve .
- Përfshirja e mekanizmave për njohjen e përvojës vullnetare si përvojë pune, për efekt të procedurave të rekrutimit të punëmarrësve brenda vendit dhe për lëshimin e certifikatave të vullnetarizmit.

5. Nxitja e aktiviteteve vullnetare për zhvillimin e shoqërisë:

- Ngritja e programeve të dedikuara për promovimin, nxitjen dhe mbështetjen veprimtarive vullnetare në vend:

- Çmimet kombëtare për vullnetarët e vitit;
- Financimi i programeve të vullnetarizmit të zbatuara nga organizatat dhe mbulimi i shpenzimeve për vullnetarët.
Ngritja e platformës elektronike të vullnetarizmit për lehtësimin e ndërlidhjes mes ofruesve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve.
- Kompensimi nga shteti i kontributit të paguar nga ofruesi i vullnetarizmit për sigurimin e vullnetarit ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- Përcaktimit të detyrave të posaçme për promovimin, nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit, për institucionet publike në fushën e punësimit, arsimit të përgjithshëm dhe profesional, rinisë, mbështetjes së shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes vendore.

Pyetjet

- 1.A mendoni se ndryshimet e propozuara, kanë zgjidhur mangësitë e Ligjit aktual nr. 45/2016?*
- 2.A mendoni se është sqaruar në mënyrë të qartë koncepti ligjor i vullnetarizmit dhe elementët përbërës të tij?*
- 3.Si e vlerësoni ndikimin e ndryshimeve të reja në ligjin për vullnetarizmin?*
- 4. A mendoni se është siguruar mbrojtja dhe fuqizimi i vullnetarëve?*
- 5.A mendoni se ndryshimet e propozuara do të nxisin rritjen e pjesëmarrjes qytetare në projektet vullnetare?*